

V E N D I M
Nr.236, datë 10.5.1993

**PËR ADMINISTRIMIN E FURNIZIMIT ME UJË PËR PËRDORUESIT FAMILJARË DHE
JOFAMILJARË**

Me propozimin e Ministrisë së Ndërtimit, të Strehimit dhe të Rregullimit të Territorit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Furnizimi me ujë të pijshëm e teknologjik nga ndërmarrja e ujësjellësit për konsumatorët privatë e shtetërorë bëhet në bazë të kontratave të shitjes që lidhen ndërmjet palëve.

2. Konsumatorët jofamiljarë shtetërorë ose privatë që furnizohen me ujë nga këto ndërmarrje, të sigurojnë dhe të vendosin me shpenzimet e tyre matësit e ujit deri në datën 31.7.1993. Ndërmarrjet e ujësjellësit përcaktojnë kapacitetin, tipin dhe projektin e vendosjes së tyre. Me kalimin e këtij afati ndërmarrjet e ujësjellësit të ndërpresin furnizimin me ujë të tyre. Pasi konsumatori vendos matësin sipas projektit të miratuar nga ndërmarrja e ujësjellësit, mbahet një procesverbal i përbashkët.

3. Administrimi dhe ruajtja e matësve të ujit bëhet nga konsumatorët jofamiljarë. Në rast dëmtimi të tyre, konsumatori duhet të njoftojë me shkrim ndërmarrjen e ujësjellësit dhe të marrë masa për zëvendësimin e tij brenda 30 ditëve. Pagesa e konsumit të ujit për këtë periudhë bëhet në bazë të normave të konsumit mesatar mujor të konsumatorit.

Nëse ndërmarrja e ujësjellësit nuk njoftohet për dëmtimin e matësit, ose matësi nuk vendoset brenda afatit të caktuar, konsumatori detyrohet të paguajë konsumin mesatar të ujit me 5-fishin e çmimit.

Pagesa për 30 ditët pasardhëse do të bëhet me 10-fishin e konsumit mesatar të ujit dhe ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë.

4. Në rast se konsumatori nuk paguan detyrimin që ka ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit në bazë të kontratës për furnizimin me ujë, detyrohet të paguajë një shtesë prej 5 për qind të vlerës së konsumit të ujit për çdo ditë-vonesë.

Nëse pagesa nuk kryhet për 30 ditë, konsumatori detyrohet të paguajë gjithë sasinë e ujit të konsumuar me 5-fishin e çmimit. Me kalimin e këtij afati ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë.

5. Ndërhyrjet në sistemin e ujësjellësit, lidhjet e pamiratuara nga ndërmarrja e ujësjellësit dhe dëmtimet e çdo lloji dënohen si kundërvajtje administrative me gjobë deri në 10 mijë lekë për konsumatorët familjarë dhe deri në 50 mijë lekë për konsumatorët jofamiljarë, si dhe me ndërprerje të furnizimit me ujë. Vendimet e dënimit jepen nga inspektori i kontrollit të ujit dhe nga punonjësi i autorizuar nga drejtori i ndërmarrjes së ujësjellësit. Kundërvajtësit detyrohen të paguajnë edhe shpenzimet e nevojshme për sjelljen e pjesës së dëmtuar në gjendjen e mëparshme.

6. Kundër vendimit të dënimit mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga shpallja ose njoftimi i tij, te drejtori i ndërmarrjes së ujësjellësit, akti i të cilit është i formës së prerë.

7. Për rastet e parashikuara në pikat 2, 4 dhe 5 të këtij vendimi, kur ndërmarrja e ujësjellësit ndërpret furnizimin me ujë, kontrata ndërmjet palëve konsiderohet e zgjidhur.

Me kërkesën e konsumatorit ndërmarrja e ujësjellësit bën rilidhjen e furnizimit me ujë brenda 30 ditëve, pasi konsumatori të ketë paguar detyrimet ndaj ndërmarrjes së ujësjellësit dhe të gjitha shpenzimet për ndërprerjen e rilidhjen e furnizimit me ujë. Pasi të jetë bërë rilidhja, konsumatori lidh kontratë të re me ndërmarrjet e ujësjellësit.

8. Ngarkohet Ministria e Ndërtimit, Strehimit dhe Rregullimit të Territorit, organet e pushtetit lokal dhe ndërmarrjet e ujësjellësit për hartimin e programit për plotësimin me matës uji të konsumatorëve familjarë.

9. Të gjitha aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë vendim, shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi